

RAFAEL NEWMAN

JASHTË

Më e brishta karrocë me pasion stolisur
prej mjeshtrit ëmbëlsuar për zakon
si strehë për eshtrat tona, trupat e cflitur
absurd përjetimesh i gjakut afeksion
mbërrin dhe krejt të shkuarën ç'më kujton!

Dhe larg një tufë zogjsh të qiellit satelitë
diellit rotull, ndërtesa dhe një sfond
Nuk munda të kuptoj në ishim frymë
a formë, a ikur...
dhe u lumturova ashtu kot.

KËNGA E PARË

A mundet lëmosha e bohemit në ritual rritur
të shërojë plagët endur rrugësh ndershmërisht?
Fjalëpakë, befasisht poshtë strehëve frymojnë
Me këngë trishtimi e treten marrëzisht

Por ç'eshtira të lodhura nën këpucë ëndrrash prehen
gjakosur nën dëshira të durimit që s'humb
mbi tokë dergjen si Ulisi natën vonë pas feste
As pikturë, as krenari kjo këngë pafund përkund.

Asgjë nuk ka ndryshuar është po ajo
Kaq i zoti shkëlqimtar ky përqaftim i rrallë
kur bota i kthen krahët ai dridhet mbi kitarë

Nata terrin ndjell ç'shtërngatë është kjo
Hëna prej së largu tallet si e marrë
E ai më të dashurën ka këngën e parë

ENGJËJ DHE PROFETË

Grumbulluar në ajër këto fjalë janë shurdhuar
Nëse larg u endën a u shpërndanë më kot
S'mundën ta bëjnë veten të kuptuar
Sido që rrodhën kohët kumti s'humbi dot

Një pamje ngjallet zgjimit me të zjarrtë mallkim
Emblemë e çdo vendi e çdo kohe që jetuam
Shndërrit mbi tokë bezdisur nga qielli si vegim
Këndon një këngë si lutje për ne që u harruam

Nderon një tjetër udhë, skeptrin e drejton
përkulur, gjunjëzuar, lutjen pëshpërit me ngadalë
për zemra kaq të pastra ky tingull i saj i rrallë

Prej hirit ngre e ndez ç'shkëlqim të zjarrtë
Muzikë të rrallë atje ku s'pati më parë kuptim
Gjer digjen fjalët, shuhen, humbin në harrim.

VËSHITIRË PER T'U KUPTUAR

Lartësuar ti sheh frymën tënde
këmbët mbi një urë që lëkundet të udhëheqin
gremisur përmes pikëllimit
nga një labirinth në një tjetër galeri myshqesh
mbi çdo rrugë një tjetër del papritur
Në këtë mbasdite turke çaji dhe cigaresh
largimi shkëlqimtar mbi hapa si era

Diku afër anijes një liman
Armiqtë e hedhur Bizantit të rrënuar
Aventura e një tjetër hordhie të etur vizitorësh
e ruan atë 16 shekuj pas lindjes

Rruga dredhon majtas, djathtas, anohet
përmbi peshën e gurit që ruan sekretin e dijes
dhe lodhet të sjellë këtë vend më mitik
se krejt mitet dhe legjenda që kishte
një qilar fantazmash në vend të pijes...

Deri sa ti të mbërrish në më të majtën galeri
ku lugetër në strofullën e tyre bëjnë dashuri
Meduzat që krahët i patën antike ç' duar praktike sot
një palë drejtuar lart e të tjera gati për sulm

Dallo tani po munde zërat rrotull teje
Kodin e ngjyrave lotuar, trokitjet e nisura në kohë
Humbur tashmë mes fërshëllimës dhe gjëmimit të një tjetër
bregu
brenda dhe jashtë teje...

Dhe vredeqekeksi që ankohet kësaj qelie
për një strofull nën hatull çatie
këtij pylli që dredhon fshehtas në një pyll frike
kësaj toke të rëndë të një perandorie bosh
përballimit rënë
vrullit të pareshtur të një bote
që nuk do të shndërrohej kurrë në gur...

Rafael Newman: Poet dhe përkthyes. Poezia e tij është përkthyer dhe botuar në revista dhe antalogji të ndryshme letrare në botë si : ‘The Hampden Sydney Poetry Review’“, ‘Poetry now’ etj. Gjithashtu ka botuar ese dhe kritika letrare, ndërsa është hartues i antologjisë “ Shkrime nga hebrenjtë e Zvicrës”. Jeton në Zyrih. Është një nga përfaqësuesit e poezisë moderne që zvicrane.